

Koço Broka-Antar



Z. Koço Broka është anëtar i Komisionit të Konkurrencës që nga data 13 korrik 2006. I lindur në Kolonjë më 10 maj 1952, Z. Broka është diplomuar për ekonomi(1976) në Universitetin e Tiranës. Ai është i specializuar kryesisht për çështjet makroekonomike lidhur me politikat financiare; politikat sociale të lidhura kryesisht me punësimin dhe reduktimin e varfërisë; politikat e administrimit publik, kryesisht për çështjet e buxhetit të shtetit; politikat e tregtisë së jashtme- zhvillimi i biznesit; politikat e zhvillimit rural në rrafshin makro dhe mikro. Në karrierën profesionale veçojmë angazhimin si Këshilltar i Ministrit të Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik, Përgjegjës sektori i politikave tregtare në Ministrinë e Ekonomisë dhe Tregtisë dhe Specialist i ndërtimit institucional në Agjencinë e Zhvillimit të Zonave Malore. Është autor i artikujve të shumtë në revista e gazeta ekonomike për problemet social –ekonomike.

Z. Broka ka ndjekur një sërë trajnimesh në fushën e ekonomisë, si në makroekonomi, kërkim tregjesh, tregti e jashtme, investime publike etj. Ai ka një përvojë të gjatë pedagogjike në lëndët e “Ekonomisë Konkrete” dhe “Menaxhimin e Burimeve Njerëzore”